1099 Prot
18.09.2013

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Adresa: "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë Tel/Fax :0035542419257 Web site: www.akp.gov.al

Nr. 698 Prot. Tiranë, më 18 . 09 . 2013

**Lënda:** listat e fituesve për vitin akademik 2013 – 2014 në programet e studimit me kohë të plotë të universitetit tuaj raundi I,faza I

**DREJTUAR:** REKTORATIT Universiteti Arteve

Bashkëlidhur ju dërgojmë listën e fituesve për vitin akademik 2013 – 2014 në programet e studimit me kohë të plotë të universitetit tuaj raundi I,faza I.

Në zarfin e secilit fakultet ndodhen:

1. lista e fituesve të të gjitha fakulteteve,
   (duhet të afishohen në vënde të dukshme, sipas udhëzimit nr. 39, dt. 14.08.2013 të MASH)
2. kredencialet (username dhe password) për hyrjen e sekretarive të fakulteteve në portalin e Maturës Shtetërore,
3. udhëzuesi për regjistrimin online të fituesve në mjediset e sekretarive mësimore të fakulteteve (Shtojca nr. 2).
4. drafti i deklaratës së fituesit për ndërprerjen e garës në këtë fazë (Shtojca nr. 3),
5. lista e konfirmimit për **Regjistrimin Paraprak** të fituesve nga ana e sekretarive të fakulteteve.

Për programet e studimit me konkurs kredencialet (username dhe password) janë të njëjta me ato që janë përdoruar për hedhjen e pikëve të konkursit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Alfons HARIZAJ**

**Drejtor i Përgjithshëm**

## Shtojca nr.2

## Udhëzues për regjistrimin on-line të fituesve në mjediset e sekretarive mësimore të fakulteteve

Për regjistrimin on-line të kandidatëve fituesve në të dyja fazat, në sekretaritë mësimore të fakulteteve, ndiqen procedurat e mëposhtme:

1. Sekretarja hap njërin nga shfletuesit e internetit (Windows Internet Explorer, Mozilla Firefox, Google Chrome) dhe lidhet me Portalin e Maturës Shtetërore nëpërmjet adresës: http://matura.akp.gov.al . Pas këtij veprimi shfaqet faqja kryesore e portalit të Maturës Shtetërore me pamjen e mëposhtme:




***Ky portal do të jetë i aktivizuar për regjistrimet në sekretari më datë 18 Shtator 2013.***

2. Klikoni mbi butonin "Identifikohuni" në pjesën e sipërme majtas të ekranit. Pas kësaj do t'ju shfaqet në ekran dritarja e mëposhtme




3. Sekretarja duhet të logohet në sistem me **Përdoruesin** (username) dhe **Fjalëkalimin** (password) të programit të studimit, në të cilin është shpallur fitues maturanti/kandidati që paraqitet për regjistrim. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi, për çdo program studimi, do t'u dërgohen nga AKP institucioneve publike të arsimit të lartë së bashku me lista e fituesve.

Në shembullin e mëposhtëm do të përdorim **Username** UT.001 dhe **Password**

ut123456 (që në këtë shembull i përket programit të studimit **Histori**).
**<u>Kujdes:</u>** Këto kredenciale duhen shkruar saktë dhe me karaktere të mëdha ose të vogla, sic janë dërguar nga AKP.Nëse bëhet ndonjë gabim në plotësimin e këtyre fushave, sistemi përgjigjet me mesazhin "Identifikimi nuk u krye. Provojeni perseri"




4. Pasi të klikojmë tek butoni "Hyr" shfaqet dritarja e mëposhtme:




5. Shkojme tek link-et Fakultete → Fituesit siç tregohet në pamjen e mëposhtme:




6. Pas klikimit të linkut Fituesit, na shfaqet dritarja e mëposhtme me listën e fituesvenë programin përkatës të studimit (në rastin tonë dega Histori)




7. Në fund të kësaj faqeje, nëse lëvizim me ashensorin vertikal djathtas, shfaqet pamja e mëposhtme e cila na jep mundësinë të shfaqim dhe pjesën tjetër të listës së fituesve të kësaj dege të paraqitura në faqet 2,3,4,5,6, ...



8. Për lehtësi kërkimi sugjerohet që të mos lëvizim me ashensor, apo nga faqja në faqe, por të përdorim opsionin Kërko me anën e Emrit, Atësisë, Mbiemrit. Për këtë qëllim plotësohen fushat e emrit, atësisë dhe mbiemrit (por jo detyrimisht të treja) me të dhënat e kandidatit që dëshiron të regjistrohet dhe klikohet te butoni Kërko, si më poshtë:




9. Nëse Butoni "Regjistrohu" është i ngjyrosur me blu, kjo tregon që studenti nuk është regjistruar më parë. Sekretarja klikon mbi këtë buton dhe shfaqet më pas pamja që paraqesim më poshtë. Në rastin kur butoni **"Regjistrohu"** është i ngjyrosur me të zezë, ai nuk është aktiv dhe kjo tregon që kandidati është regjistruar më parë në sistem në mjedise jashtë fakultetit. Në këtë rast sekretarja nuk mund ta regjistrojë sërishmi.
10. Pas klikimit te butoni **"Regjistrohu"** shfaqet dritarja e mëposhtme që kërkon konfirmimin e sekretares për regjistrimin e studentit.




11. Pas konfirmimit me anë të klikimit mbi butonin **OK,** shfaqet dritarja e mëposhtme:




12. Në këtë moment sekretarja pyet kandidatin nëse dëshiron të vazhdojë konkurrimin në fazën e dytë për ngjitje në preferencat më të larta të tij të përzgjedhura në formularin A2. (Në rast përgjigje pozitive, përzgjidhet opsioni **"Ruaj"** dhe pajiset

kandidati me një fletë- regjistrimit (faza e parë) të firmosur dhe vulosur nga personat përgjegjës të fakultetit. Gjithashtu, kandidati, firmos së bashku me sekretaren në listën e konfirmimit të regjistrimeve të kandidatëve fitues të fazës së parë. Në fletët e regjistrimit dhe në regjistrat e konfirmimit duhet të paraqiten data dhe ora e regjistrimit.

13. Në rastin kur kandidati shpreh dëshirën që të ndërpresë konkurrimin për të mbetur i regjistruar në preferencën në të cilën u shpall fitues në fazën e parë (lista paraprake e fituesve) klikohet mbi opsionin **"Konfirmoj regjistrimin përfundimtar në preferencën e fituar"** dhe më pas tek butoni **"Ruaj"** (shih dritaren e mëposhtme). Pas pajisjes me fletën e regjistrimit si më lart, sekretarja merr një deklaratë të kandidatit që tërhiqet nga gara për fazën e dytë të shpalljes së fituesve. Ky kandidat mbetet fitues në programin e regjistrimit të shpallur në fazën e parë. Ashtu si edhe në vitet e kaluara në këto lista duhet të firmosë për çdo regjistrim sekretarja dhe studenti i regjistruar dhe më pas çdo fletë e listës të firmoset dhe vuloset nga Dekani i Fakultetit.




14. Nëse brenda afateve zyrtare të regjistrimit online të studentëve, 18 deri 23 shtator 2013, ora 18.00, ndonjë prej studentëve të regjistruar në sekretari, paraqitet sërishmi me pretendimin që kërkon të mbetet në preferencën e fituar në këtë fazë, duke ndërprerë garën, kjo gjë mund t'i realizohet duke ndjekur procedurat e mëposhtme:
Shkojmë tek link-et Fakultete → Të regjistruar siç tregohet në pamjen e mëposhtme:




Pas klikimit mbi opsionin të regjistruar na shfaqet lista e studentëve të regjistruar

në fakultet në programin përkatës të studimit si më poshtë.




15. Pasi kërkohet rekordi i kandidatit me metodat e përshkruara më sipër, klikohet mbi butonin "Dil nga Gara" dhe menjëherë ndryshon statusi i tij i regjistrimit nga opsioni "Dil nga Gara" në opsionin "**Mbetet në këtë preference**".

__**Kujdes!**__ Këtij studenti duhet t'i kërkohet nënshkrimi i deklaratës së tërheqjes nga gara, t'i jepet fleta e regjistrimit (faza e parë), pasi të ketë dorëzuar dokumentin e regjistrimit të dhënë më parë dhe të pasqyrohet në regjistrin që do të përcillet në **AKP**.

16. Kolona e fundit e fundit ka të bëjë me procedurën e regjistrimit të kandidatit, në fazën e dytë dhe përfundimtare nga data 7 tetor 2013 deri në 13 tetor 2013. Dorëzimi i dokumenteve plotësues në sekretarinë mësimore bëhet nga kandidati gjatë javës së parë të frekuentimit në fakultetin përkatës.

Në fazën e parë të regjistrimit ajo nuk do të shfaqet (është e padukshme). Në fazën e dytë ajo është aktive dhe bëhet e padukshme kolona e parafundit.

**Agjencia Kombëtare e Provimeve**

<u>Shtojca nr. 3</u>

Datë: ______. _______. 2013

UNIVERSITETI ________________________________________

FAKULTETI __________________________________________

PROGRAMI I STUDIMIT __________________________________

Të dhënat e kandidatit:

Emri ___________________

Atësia ___________________

Mbiemri ___________________

DEKLARATË

Deklaroj në përgjegjësinë time personale se dëshiroj të mbetem në këtë program studimi, duke hequr dorë nga e drejta e vazhdimit të garës në fazat e mëtejshme të konkurrimit.

Kërkoj të paisem me vërtetim të regjistrimit përfundimtar.

| Emër | Mbiemër | Firmë |
| --- | --- | --- |
| ______________ | ______________ | ________________ |

( emri të shkruhet me dorë nga vetë kandidati)